



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:120944

Datë: 30.04.2021

Numri i dokumentit: 01752106

PKR.NR.215/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësorë Dafina Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. S. nga fshatiK-, për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr.949/19 të dt. 13.06.2019 ,pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurores së shtetit Sahide Gashi, të akuzuarit B. S., me dt. 29.04.2021, mori dhe m e dt. 29.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. S., i biri i R. dhe nenën M. e vajzërisë Z., i lindur më ne tani me banim ne fsh.K-, ku dhe banon ka te kryer shkollën e mesme, me profesion elektrikist, i martuar, i gjendjes se dobët ekonomike , i identifikuar me baze te letërnjoftimit me numër personal posedon numër telefonit, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

1. Konform nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPRK-së **REFUZOHET AKTAKUZA**

Për shkak se:

Me parë e gjerë me dt. 01.04.2019, rreth orës 20:45, në fsh. K....., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par 1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë: një pushkë gjuetie kal. 12 mm, me numër serik 08693, prodhim jugosllav-Zastava, në atë mënyrë që ditën kritike pasi që policia e Kosovës Kanë marrë informatë se i pandehuri i lartcekur posedon armë pa leje, policia shkojnë në vendi e lartcekur dhe tek i pandehuri B. S. në shtëpinë e tij policia kanë gjetur dhe konfiskuar armën me të dhënat e sipërshtuar,

- Me çka kishte për të kryer veprën penale mbajtja në pronësi kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së.

2.KONFFISKOHET - një pushkë gjuetie kal. 12 mm, me numër serik 08693, prodhim jugosllav-Zastava, të cilat gjenden me nr. të rastit 2019-DF-132, ku pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit urdhërohet që të njëjtat të shkatërrohen.

I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i përgjithëshem, ka ngrit aktakuzë pranë gjykatës Themelore në Istog PP/II.nr.949/19 të dt. 13.06.2019, kundër të akuzuarit B. S. nga fshatiK-, për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se dhe njëkohësisht ka dërguar edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Seanca e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë është mbajtur pranë gjykatës themelore në Istog md dt.21.08.2019 ku dhe i akuzuari mbrojtësja e tij, prokurori kan konfirmuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Gjykata ka pranuar një marrëveshje të tillë me aktgjykim P.nr.141/19 të dt.21.08.2019 ka gjykuar të akuzuarin me dënim me gjobë në shumën prej 200 eruo të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi, është obliguar në pagesn e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro. I sëhtë shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës.

Ndaj aktgjykimit të cekur më larët ka paraqitur ankesë mbrojtësja e të akuzuarit për shkak të vendimit mbi dënim. Gjykata e apelit duke vepruar sipas ankesës me aktvendim PN.nr.603/2020 dt.18.09.2020 ka kthyer çështjen në rigjykim ashtu me arsyen se çështja bie në kompetencë të departamentin e krimeve të rënda.

Pas marrjes së vendimit të Gjykatës së Apelit nga dega e gjykatës në Istog është dërguar në kompetencë lënda në departamentin e krimeve të rënda të kësaj gjykate.

Pas marrjes së lëndës në kopetenc është caktuar sërish seanca për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Para leximit të aktakuzës PP/II.nr. 949/2019, te dt. 13.06.20219 nga ana e Prokurorit të shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 29.04.2021, prokurorja e shtetit Sahide Gashi , deklaroi se : ne periudhën kohore kur është kryer vepra penale nga këtu i pandehurit B. S. e qe është 01.04.2019, sipas vendimit te Qeverise se Kosovës nr. 536/2018, te dt. 23.11.2018, është shpallur afati kohore për fillimin e procedurës se legalizimit te armëve ne afat prej 6 muaj, duke filluar nga data 17. Dhjetore 2018, deri me 17 qershor 2019, brenda se cilës periudhë pezullohet zbatimi i nënti 374 i Kodit Penale te Republikës së Kosovës, e qe është analoge me nenin 366 te KPRK-se. Qe do te thotë ndjekja penale ndaj te njëjti është pezulluar ne kohen kur është kryer vepra, andaj kjo prokurori ne prezencën e këtyre rrethanave e konform nenit 52 te KPP tërhiqet nga ndjekja penale për te njëjtit për derisa mbetem pranë propozimit për konfiskim te armës dhe atë nje pushke gjuetie e kalibrit 12 mm, me numër serik 08603, prodhim Jugosllav - Zastava me pajtim me dispozitat e nënti 366 prg 3 te KPRK-se, meqenëse për te njëjtën nuk ka leje nga Organet kompetente dhe nuk mund te lejohet ne qarkullim e qe gjendet ne zingjirin e ruajtjes te Stacionit Policore ne Istog e konfiskuar përkohësisht sipas vërtetimin 2019- DF- 132 , te dt. 01.04.2019.

I akuzuari B. S. nuk e kundërshton deklarinimin e prokurores së shtetit dhe u pajtua për të njëjtën.

Andaj gjykata konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së e refuzoi aktakuzën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi qe prokuroria hoqi dorë nga aktakuza PP/II.nr. 949/2019, te dt. 13.06.20219, kundër të akzuarit B. S. për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se.

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së dhe nenit 282 par. 1 të KPPRK-së gjykata ka konfiskuar armën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 454 të KPPRK-së gjykata ka liruar të akzuarin nga shpenzimet e procedurës penale.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2019:120944, 30.04.2021

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.